



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.1506/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Ujësjetllësi Rajonal “Prishtina” sh.a, me seli ne Prishtinë rr.”Tahir Zajmi” pn, ndaj debitorit “Furra Sheki” me pronar R.O. me seli ne Prishtinë lagja “Veternik” 001, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë –Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.713/23 dt.20.09.2023, me datën 31.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e kreditorit Kompania Ujësjetllësi Rajonal “Prishtina” me seli ne Prishtinë rr. Tahir Zajmi” pn, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës – Dhoma e Shkallës së Parë –Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.713/23 i datës 20.09.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale te Kosovës–Dhoma e Shkalles së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.713/23 dt.20.09.2023, e ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit “Furra Sheki” me seli ne Prishtinë lagja “Veternik” 001 dhe e ka shfuqizuar urdhrin përmbarimor P.nr.399/14 dt.23.09.2014, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Isa Gacaferri me seli ne Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak te shkeljes esenciale te dispozitave te procedurës civile, vërtetimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike dhe zbatimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës se dytë, këtë ankesë ta aprovoj, aktvendimin e atakuar ta anuloj dhe çështjen ta kthej ne rivendosje ose aktvendimin e atakuar ta ndryshoj dhe prapësimin e debitorit ta refuzoj.

Dhomat e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kompania Ujësjellësi Rajonal “Prishtina” me seli ne Prishtinë rr.”Tahir Zajmi” pn, me datën 19.09.2014, ka paraqitur propozim për përmbaram ndaj debitorit “Furra Sheki” me pronar R.O. me seli ne Prishtinë lagja “Veternik” 001, në bazë të dokumentit të besueshëm - Ekstraktit te verifikuar nga librat afarist te kontabilitetit nen shifrën 1620. Përmbaruesi Privat Isa Gacaferri nga Prishtina, sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbarimor P.nr.399/14 dt.23.09.2014, ka lejuar përmbarimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër te detyrimit për furnizim me ujë te pijshëm, ti paguaj shumën prej 14.980.99 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita pranimit te këtij urdhri si dhe shpenzimet e procedurës.

Kundër urdhrit përmbarimor debitori ka paraqitur prapësim me datë 08.10.2014, me pretendimin se propozimi për përmbaram nuk i përmban elementet e parapara me ligj dhe si i tillë nuk mund te përmbarohet, shton se gjykata ka qenë e detyruar t’ia kthej kreditorit ne përmirësim për ta rregulluar propozimin, dhe propozon qe gjykata ta aprovoj këtë prapësim si te bazuar ndërsa urdhri përmbarimor te shfuqizohet dhe procedura te pezullohet.

Përgjigje ne prapësim ka paraqitur kreditori me datën 10.10.2014, me arsyetimin se pretendimet e debitorit janë te pabazuara, shton se debitori ka pranuar me rregull faturat dhe nuk ka pasur asnjë kundërshtim lidhur me to si dhe me emrin me te cilin është faturuar, ekstrakti përmban muajt, vitet, vlerën e borxhit dhe kodin.

Gjykata Komerciale e Kosovës- Dhomat e Shkallës se parë, pas vlerësimit të prapësimi dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.713/23 dt.20.09.2023, me të cilin ka vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Arsyeton se në ri procedurë ka marrë parasysh vërejtjet e Gjykatës se Apelit, pretendimet e palëve dhe ka gjetur se urdhri mbi lejimin e përmbarimit është bërë ne kundërshtim me nenin 38 par.1 te LPP, sepse ne propozimin për përmbaram nuk janë dhënë te dhënat e mjaftueshme ne drejtim te identifikimit te debitorit por propozimi është ushtruar ndaj Furra Sheki-R.O. rr.”Veterniku”-001, duke mos treguar emrin e debitorit, numrin e biznesit te tij, apo te dhëna tjera te debitorit, pra vetëm përshkrimi Furra Sheki-R.O. rr.”Veterniku”-001, pa treguar emrin e debitorit dhe numrin e biznesit nuk është e mjaftueshme për identifikimin e saktë te tij. Gjykata i referohet edhe nenit 43 par.4 te LPP dhe përcakton se gjykata ne fazën e procedurës sipas mjetit juridik kufizohet vetëm ne shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e te cilit është lejuar përmbarimi, andaj ne këtë rast urdhri është lejuar pa plotësuar kushtet për lejimin tij, ashtu siç parashohin dispozitat ligjore nga neni 38 par.2 te LPP-së sepse ne rastin konkret vlerëson se ekstrakti nen shifrën 1620 nuk plotëson kushtet ligjore për te qenë dokument i besueshëm siç parasheh neni 29 pika 1.2 e LPP, pasi kreditori ne propozim ka kërkuar përmbushjen e borxhit prej 14,980.99 euro pa specifikuar periudhën kohore për te cilën është krijuar borxhi pasi në ekstrakt tek gjendja fillestare tek Saldo figuron shuma prej 2,039.54 euro por nuk është paraqitur periudha kohore për te cilën është krijuar

ky borxh andaj nuk mund te vërtetohet si ka ardhur deri tek borxhi dhe si rrjedhojë e kësaj ky dokument nuk pasqyron saktë detyrimin që rrjedh nga i njëjti, kështu që mbi këtë bazë gjykata ka vendosur si ne dispozitiv të aktvendimit të saj.

Dhoma e Shkalles së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata shkallese së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e shkallese së Dytë, bazuar nga shkresat në lëndë vlerëson se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se kreditori në propozimin për përmbarim nuk ka vepruar konform nenit 38 par.1 dhe 2 të LPP-së, sepse nuk ka treguar të dhëna të mjaftueshme të cilat identifikojnë debitorin në këtë rast propozimi nuk ka numrin e biznesit të debitorit e as numrin personal identifikues të palës siç parasheh neni 38 i LPP në këtë rast të debitorit, po ashtu Organi Përmbarues nga shkresat e lëndës rezulton të mos këtë ndërmarr asnjë veprim në pajtim me nenin 102 të LPK për ta korrigjuar propozimin për përmbarim. Lidhur me këtë çështje edhe kjo gjykatë vlerëson nenin 43 par.4 të LPP. Më tej dokumenti mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi del të mos jetë në përputhje me dispozitat ligjore përkatësisht nenin 29 par.3 të LPP i cili përcakton se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”, pasi në rastin konkret është e paqartë se cila është shuma e saktë e detyrimit të debitorit ndaj kreditorit sepse në këtë dokument publik është e përshkruar periudha kohore nga data 01.01.2013 deri me 18.08.2014, mirëpo në fakt në propozimin për përmbarim nuk është e përcaktuar fare periudha kohore për të cilën kërkon përmbushjen e detyrimit gjë që rezulton si e pasaktë edhe shuma e detyrimit të kërkuar. Në përmbajtje të dokumentit mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi tek saldo figuron shuma prej 20,154.4 euro mirëpo nuk dihet se për cilën periudhë kohore është ky detyrim, andaj është i paqartë fakti se nga ka ardhur ky borxh i kërkuar nga kreditori, nga rrjedh se ky dokument nuk plotëson kushtet ligjore për të qenë i ekzekutueshëm. Andaj mbi këtë bazë kjo gjykatë e pranon në tërësi përfundimin juridik të gjykatës e shkallese së parë lidhur me gjendjen faktike të konstatuar nga e njëjta.

Kjo gjykatë ka analizuar edhe pretendimet e kreditorit por të njëjtat vlerësoj se nuk janë relevante për një vendosje ndryshe, ashtu që i ka refuzuar ndërsa aktvendimin e atakuar e ka vërtetuar.

Përndryshe, në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,  
Dhomat e Shkallës së Dytë  
K.DH.SH.II nr.1506/23, me datë 31.05.2024

Gjyqtari,  
Krenar Berisha